



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 83 /2018
Datë: 29 janar 2018

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 29 janar 2018, mori këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet Rekomandimi i Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për kompensim të ish prokurorit të shtetit, Suad Kuraja.
- II. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim të ia dërgojë ish prokurorit të shtetit, z. Suad Kuraja.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Ish prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, z. Suad Kuraja, i cili ka përfunduar mandatin e prokurorit për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datë 28 mars 2016, ka bërë kërkesë për realizimin e tri (3) pagave mujore me rastin e shkurajës në pension. Këtë kërkesë ish prokurori Kuraja e ka bazuar në nenin 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 26 dhejtor 2017, ka themeluar Komisionin Ad Hoc për trajtimin e kësaj kërkesë dhe t'i sjell rekomandim Këshillit lidhur me këtë kërkesë.

Komisioni e ka trajtuar kërkesën e paraqitur nga ish prokurori Suad Kuraja dhe ka rekomanduar që kjo kërkesë duhet të refuzohet. Këtë rekomandim Komisioni e ka dhënë duke u bazuar në Ligjin e Punës, dispozitat e Ligjit për Këshillin Ekonomiko - Social dhe Ligjit mbi Organizimin Sindikal, Statutin e sindikatës së pavarur të judikaturës së Kosovës, Marrëveshjen e përgjithshme kolektive të Kosovës të lidhur me Qeverinë e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, konsultimeve me kolegë nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ku është vërtetuar se prokurorët e Prokurorisë Speciale nuk janë të organizuar dhe

anëtarësuar në sindikatën e Judikaturës e cila sindikatë hyn në kuadër të BSPK-së në të cilën sipas statutit të saj ka të drejta dhe obligime si psh, pagesa e anëtarësisë për çdo muaj sikurse janë shumica e prokurorive tjera në nivel vendi, pasi që kështu përcakton Marrëveshja e Përgjithshme kolektive të Kosovës e lidhur me Qeverinë e Kosovës dhe e cila ka hyre në fuqi nga data 01.01.2015.

Andaj, bazuar në të gjitha të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- *Z. Suad Kuraja;*
- *Sekretariatit;*
- *Arkivit të KPK-së.*